# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-456642**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kosova pa kapitenin e deritashëm dhe me talentin e madh të Bayernit |
| ADRESA | `https://www.koha.net/futboll/kosova-pa-kapitenin-e-deritashem-dhe-me-talentin-e-madh-te-bayernit` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 01:17:15 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 18 shtator 2026, 13:11:23 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `49a1f88ae4edbee6f3de697104ae9a7c74ebb408bd9596a8052114d1bbbac428` |
| TEKSTI | `81a14ebdc0236747af98979253feb77a1eb9f816c176a6026938ee02784319e8` |
| PAMJA | `b56b44132553bd2909df9e2259f17008c2d872916dffd291a8b7b361149a4c12` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b10e5703f5827230709e8dcf96355e2527329246641b7bd035c6c6d37bc31cc1` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9820c0ddeb45471f928207a963ca36ba3aaf52dec6ebed920f8d826671ee6c4b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b10e5703f5827230709e8dcf96355e2527329246641b7bd035c6c6d37bc31cc1`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

FUTBOLL

# Kosova pa kapitenin e deritashëm dhe me talentin e madh të Bayernit



Nga: Arsim Maxhera 

18 shtator 2026 15:11

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Fillimi i edicionit të ri të Ligës së Kombeve të UEFA-s shënon edhe fillim të një epoke të re për ekipin kombëtar të Kosovës në futboll.

Selektori Franco Foda të premten publikoi listën e lojtarëve në të cilët llogaritë për katër ndeshjet e para të edicionit të pestë të Ligës së Kombeve.

Në listë nuk është kapiteni i deritashëm, Amir Rrahmani, që ka vendosur të largohet nga përfaqësuesja i pakënaqur me drejtuesit e FFK-së. Për më tepër, mbrojtësi i Napolit ka bërë akuza të rënda ndaj drejtuesve të Federatës. Mungon në listë edhe Florent Hadërgjonaj, që nuk është ftuar rregullisht së fundi. Ai të enjten deklaroi se largohet nga ekipi, i pakënaqur me shtabin teknik. Ndërkohë të premten është publikuar vendimi për përfundim të karrierës ndërkombëtare nga mesfushori Valon Berisha dhe mbrojtësi Fidan Aliti.

Për shkak të lëndimeve mungojnë Elvis Rexhbeçaj, Florent Muslija dhe Kreshnik Hajrizi.

Në listë bie në sy emri i talentit të madh të Bayernit, Erblin Osmani. 17-vjeçari ka luajtur për U16 dhe U17 të Gjermanisë. Mesfushori tashmë ka debutuar për ekipin e parë të Bayernit dhe vlerësohet e ardhmja e përfaqësueses së Kosovës.

Edhe



Futboll • 9 o. më parë
Publikohet lista e Kosovës, ftohet Osmani i Bayernit

Dion Kaçuri është emër tjetër i ri në listë. Mesfushori 22-vjeçar ka luajtur për të rinjtë e Zvicrës. Nuk është përmendur si kandidat për Zvicrën A. Aktualisht tek Austria Lustenau, në huazim nga Baseli, Kaçuri pritet t'i shërbejë forcimit të konkurrencës në mesin e fushës.

Milot Avdyli është ftuar për herë të parë te Kosova A. Më herët ishte pjesë e rëndësishme e Kosovës U21. 24-vjeçari është

**Arbëri.**
Jashari: PDK-ja duhet ta ketë Ministrinë e Drejtësisë

**Futboll.**
Brentfordi turpëron Chelsean

**LAJMET E MBRËMJES.**
Bashkëpunëtorë dhe bashkëveprimtarë e kujtojnë kontributin e Flora Brovinës

**Futboll.**
Bayerni me fitore 7:0, Kane vendos rekord

**Kronikë.**
Dy të therur me thikë në shesh të Mitrovicës

**Arbëri.**
"Jo në emrin tim", mijëra qytetarë në natën e tretë rresht kundërshtojnë vendimin e Speciales

shpërblyer për paraqitjet e mira te Celje në Slloveni.

Të tjerët janë emra të konfirmuar, ndërsa disa kthehen në ekip. Arijanet Muriq, Amir Shaipi dhe Visar Bekaj janë portierët e ftuar.

Albian Hajdari pritet të jetë lider i ri i mbrojtjes, kurse pos tij janë ftuar edhe Mërgim Vojvoda, Lumbardh Dellova, Ilir Krasniqi, Ron Raçi, Leard Sadriu e Dion Gallapeni.

Leon Avdullahu vlerësohet i pazëvendësueshëm në mesfushë. Prej mesfushorëve dhe sulmuesve të krahut janë ftuar edhe Ermal Krasniqi, Baton Zabërgja, Veldin Hoxha, Vesel Demaku, Lindon Emërllahu, Donat Rrudhani, Muharrem Jashari, Valmir Matoshi, Milot Rashica, Edon Zhegrova. Për qendër të sulmit konkurrojnë të zakonshmit Vedat Muriqi, Fisnik Asllani e Albion Rrahmani.

Kosova më 24 shtator luan në Prishtinë me Irlandën. Më 27 shtator është ndeshja Austri – Kosovë. Më 1 tetor në Debrecen luhet takimi Izrael – Kosovë, ndërsa më 4 tetor Kosova e pret Austrinë në “Fadil Vokrri”.


Edhe



Futboll • 26 maj 2026

“Fillimi i ri”, me emra të konfirmuar


Kosova kërkon suksesin në Ligën e Kombeve, pasi luajti në finale të plejofit kualifikues për Kupën e Botës 2026. Kosova për herë të parë do të luajë në Ligën B të Ligës së Kombeve.

Grumbullimi i lojtarëve bëhet të hënën. Stërvitja e parë është nga ora 17:00 në “Fadil Vokrri”.

#KOSOVA #LISTA #FRANCO FODA #LIGA E KOMBEVE

## Artikuj të ngjashëm




Futboll • 20 mar 2026

Foda shpall listën, Kosova me mungesa të rëndësishme



Futboll • 19 mar 2026

Pas kapitenit, Kosovës i lëndohet edhe lideri i mesfushës



Futboll • 3 tet 2025

Ftohet Hajdari, kthehen Zhegrova e Rashica



KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatësisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS

Download on the App Store

GET IT ON Google Play



+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.